

Spiropali: Arkëtuam 3.9 milionë USD më shumë

Dogana arkëtuam në muajin e dytë të vitit 101 milionë dollarë, nga 97 milionë të planifikuar. Në një konferencë për shtyp, drejtoresha e Përgjithshme e Doganave Elisa Spiropali dha edhe shifrat e realizimit. "Administrata doganore edhe në muajin shkurt 2014 vijon arritjet e saj duke realizuar planin e të ardhurave për këtë muaj me 104%, duke arkëtuar 393 milionë lekë më shumë se plani", tha Spiropali. Sipas saj, shkurti i këtij viti rezultoi më i mirë sesa shkurti i një viti më parë sa u përket të ardhurave të arkëtuara. "Gjatë muajit shkurt 2014 u arkëtuam rreth 1.2 miliardë lekë më shumë se muaji shkurt 2013, gjatë së cilit u arkëtuam 8 miliardë e 989 milionë lekë", tha drejtoresha e Doganave. Në daljen e saj publike, Spiropali solli në vëmendje edhe marrëveshjen e miratuar nga FMN-ja duke e cilë-

suar atë si një arritje të qeverisjes socialiste dhe pas kësaj shtoi se vetëm në pesë muaj qeverisje në Dogana janë mbledhur miliona dollarë më shumë se një vit më parë. "Vetëm nga administrata doganore në 5 muajt e fundit janë arkëtuar 8 miliardë e 700 milionë lekë (84 mln USD) më shumë se e njëjta periudhë paraardhëse. Vendosi mëria dhe serioziteti në bërjen reformave, lufta kundër korrupsionit dhe trafiqeve të paligjshme, marrëdhënia e re e partneritetit me biznesin, ndalimi i kurbës rënëse në vjeljen e të ardhurave kanë qenë prova e besimit për partnerët ndërkombëtarë për këtë injeksion në ekonominë shqiptare", tha ajo. Aktualisht Doganat janë duke u asistuar nga kompania "Crown Agents", me të cilin shteti ka një kontratë dyvjeçare dhe me mundësi shtyrjeje edhe me një vit.



Drejtoresha e Doganave, Spiropali

Flet kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Siguracionet, Shehi: Brenda vitit fillon sistemi bonus-malus

"Ndryshimi i çmimeve, paketë me FMN dhe BB për qëndrueshmërinë e tregut"

NERTILA MAHO

Tregu i sigurimeve këtë vit do të ketë dy zhvillime të rëndësishme: fillimin e zbatimit të sistemit të bonus-malus dhe një paketë stabilizuese që synon vendosjen e qëndrueshmërisë së çmimeve dhe vlerësim real të riskut.

16



MIJE LEKE është aktualisht primi mesatar i sigurimit që aplikohet nga kompanitë për produktin e MTPL-së. Kompanitë kanë diferenca të vogla mes njëra-tjetrës sa u përket primeve, çka është kritikuar nga Konkurrenca

21



MIJE LEKE arriti primi i sigurimit të mjeteve pak javë më parë, nga 14 600 lekë që kishte disa kohë që qëndronte. Rritjet dhe uljet e primeve kanë kohë që përkufizojnë tregun e sigurimeve nga liberalizimi i tij

Në një intervistë për gazetën, kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Enkelelda Shehi, shprehet se për paketën e masave po punohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore me synim forcimin e kërkesave për rezervën minimale të kompanive, likuiditetin dhe tregues të tjerë të sektorit. Nga ana tjetër Shehi shprehet se po punohet për sistemin e ri dhe implementimi i bonus-malus duhet të kalojë në procedura specifike institucionale. Kjo, sipas saj, ka të bëjë me lidhjen e sistemit online mes institucioneve të përfshira, kurse paralelisht me kompanitë e sigurimit po punohet për saktësimin e të dhënave.

Në çfarë faze është aktualisht projekti për aplikimin e bonus-malus? Çfarë pune po bëhet me kompanitë e sigurimit dhe kur mendohet të fillojë zbatimi konkret i sistemit?

Implementimi i sistemit bonus-malus është ende në proces për shkak të fazave që duhet të kalohen për ndërlidhjen e bazës së të dhënave të institucioneve shtetërore. Për shkak të detyrimeve ligjore kjo ndërlidhje duhet të

kryhet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Kjo agjenci është përgjegjëse dhe ndërmjetëse e lidhjeve të sistemeve të institucioneve shtetërore. Aktualisht AMF është në fazën e regjistrimit të bazës së të dhënave të Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Pas regjistrimit dhe aprovimit, procesi kalon në një kërkesë që i bëhet AKSHI-t për të aksesuar gjendjen civile e pas aprovimit të kësaj kërkesë bëhet zhvillimi i aplikacioneve të duhura, të cilat e mundësojnë këtë lidhje. Me shoqëritë e sigurimit aktualisht po punohet në drejtim të përmirësimit të cilësisë së të dhënave që janë në regjistrin e policave dhe regjistrin e dëmeve. Bazat e të dhënave kryesore të AMF-së janë regjistri i policave dhe regjistri i dëmeve. Në regjistrin e policave raportohen shitjet nga të gjithë agjentët e sho-

qërive të sigurimit. Brenda muajit mars AMF do t'u prezantojë projektin IT shoqërive të sigurimit, i cili tashmë është përgatitur dhe do të fillojë menjëherë zbatimin. Sistemi pritet të jetë i zbatueshëm brenda vitit 2014.

Po me institucionet e tjera shtetërore në çfarë pikash po bashkëpunohet?

Për sistemin bonus-malus bashkëpunohet me DPSHTRR (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor) dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC). Me DPSHTRR është arritur një marrëveshje dhe një lidhje teknike, ndërsa me DPGJC është në proces për shkak të detyrimeve ligjore, të cilat e kërkojnë këtë ndërlidhje nëpërmjet AKSHI-t, në kuadër të portalit qeveritar të njehsuar. Procedura e njehsimit, pas dorëzimit të dokumenteve mund të vazhdojë deri në 120 ditë për



Kryetarja e AMF, Enkelelda Shehi

aprovim sipas VKM-së 945, "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore".

Çfarë përfitimesh konkrete do të ketë për qytetarët?

AMF beson që në afatgjatë përfitimet do të jenë në nivel kombëtar, nëse programi mund të zbatohet. Në shumë vende një qasje e tillë e strukturuar ka ulur ndjeshëm frekuencën e aksidenteve dhe primet e sigurimit, duke përmirësuar ndjeshëm dhe efektin social që lidhen me drejtimin e automjetit. Ndërsa në mënyrë më të drejtpërdrejtë, konsumatorët do të kenë mundësinë të marrin një produkt, i cili do të jetë i personalizuar në drejtim të çmimit, për shembull me përvojën e tyre të drejtimit të mjetit, që do të thotë se drejtuesit e mirë nuk kanë pse financojnë primin e drejtuesve të këqij.

Cilit model do t'i referohet Shqipëria?

Metodologjia e sugjeruar është hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe ka marrë parasysh eksperiencat e shumë vendeve

europiane apo që kanë pasur sfida të ngjashme si Shqipëria. Fillimisht sugjerohen disa faktorë që mund të përdoren, si: zbatimi i një shkalle bonus-malus, fuqia motorike, zona e banimit etj. Zbatimi i faktorëve të ndryshëm vjen gradualisht pasi tregu fiton përvojë në tarifimin me bazë risku.

Lidhur me destabilitetin që ka shfaqur liberalizimi i MTPL, a po merret ndonjë masë për ta bërë më të qëndrueshëm?

Në bashkëpunim me FMN-në dhe Bankën Botërore, AMF po përgatit një paketë stabilizuese, e cila ka për qëllim të forcojë kërkesat në lidhje me rezervat minimale, likuiditetin, zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, si dhe një sërë masash me ndikim afatgjatë, të tilla si zhvillimi i programeve për sigurimin e përgjegjësive të shërbimeve të ndryshme apo të risqeve nga ngjarjet e natyrës së katastrofave. Sigurisht që e gjithë strategjia për stabilizim do të vihet në jetë në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në janar



Bie numri i kontratave, u rritën primet

Muaji i parë i vitit shënoi një rënie në numrin e kontratave që janë lidhur mes individëve dhe kompanive të sigurimit, por kjo nuk është reflektuar në aspektin monetar, i cili ka ecur në kahun e kundërt. Të dhënat e fundit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se numri i kontratave në fund të janarit ishte 72.898, me një rënie 11.21 për qind krahasuar me një vit më parë. "Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e jo-jetës kap shifrën 855.599 mijë lekë dhe shënon një rritje në masën 34.94%, krahasuar me janarin e vitit 2013", thuhet në raportin e AMF-së për muajin e parë të 2014-s. Rënie kanë shënuar kontratat që lidhen me sigurimin e jo-jetës. Numri i tyre ishte 66.216, duke shënuar një rënie prej 12.79 për qind krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë, ndërkohë që volumi i primeve të shkruara bruto ka shënuar një rritje me 4.91 për qind.

Kompanitë gjatë muajit janar mbajtën çmime standarde prej 14 600 lekësh për një prej produkteve më të njohura të tyre, siç është MTPL-ja. Një nivel i tillë çmimesh është dukshëm i lartë krahasuar me tendencën që kanë pasur çmimet muaj më parë, por sipas AMF-së çmimet e ulëta janë të rrezikshme për tregun, pasi nuk mbulojnë riskun. Një rezultat pozitiv për janarin është ai i pagesës së dëmeve bruto. Raporti tregon se u paguan 201 milionë lekë dëme me një rritje 17.91 për qind krahasuar me janarin e një viti më parë. Treguesi pozitiv për këtë pjesë ka qenë shqetësues gjatë vitit 2013, pasi pagesa e dëmeve shënonte ulje të vazhdueshme dhe kjo argumentohej me primet e ulëta që aplikonin kompanitë në treg për produktet e tyre.